



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 352/1 Prot.

Tiranë, më 05.03.2019

V E N D I M

Nr. 36 , Datë 05 / 03 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.129 Regj, datë 29.08.2018 të Fondacionit Doën Syndrome Albania, kundër kompanisë Bio Save Tirana, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë KMD-së është cituar se kompania Bio Save Tirana po shpërndan testin e quajtur Harmony Prenatal Test, test i cili bëhet nga gratë shtatzëna për të zbuluar gjendjen e kromozomeve tek fëmija. Në vijim, Fondacioni Doën Syndrome Albania shprehet se, nga kjo kompani janë shpërndarë edhe broshura të cilat përmbajnë informacion të gabuar rreth sindromës doën, pasi në shpjegimin e kësaj sindrome broshurat citojnë: “...*mangësi të lindura: zemra, fytyra, rritja*”, gjë që sipas tyre jep informacion keqorientues për prindin. Ata kërkojnë që informacioni të jetë i plotë dhe i saktë për këtë sindromë; të ketë të vendosura linqe dhe burime për një informacion më të detajuar.

Po ashtu, janë ankuar edhe për sloganin e përdorur nga kjo kompani: “Të jeni të lumtur!”, slogan i cili mendohet të jetë marrë nga kompania origjinale e cila përdor sloganin “Be careless!”. Fondacioni Doën Syndrome Albania pretendon që përshtatja është e gabuar, paragjykyese dhe

diskriminuese, pasi nënkupton që një familje me fëmijë me sindromën doën nuk është një familje e lumtur.

Ky fondacion kërkon nga Komisioneri që të detyrojë kompaninë Bio Save Albania:

“Të korrigojë informacionin e dhënë në materialet/broshurat e shtypura për sindromën doën dhe sloganin. Të tërheqë nga tregu të gjitha materialet e publikuara mbi testin prenatal. Të vendosë linjë dhe burime zyrtare mbi marrjen e informacionit të saktë mbi sindromën doën. Të kërkojë falje publike pasi nëpërmjet këtij informacioni ka lënduar një komunitet prindërisht dhe ka dëmtuar imazhin dhe punën e një organizate që punon për gjithëpërfshirjen dhe të drejtat e personave me sindromën doën”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Neni 3 i LMD-së, në pikën 5 të tij, parashikon shprehimisht se: *“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

¹Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1182/2 prot., datë 07.09.2018 i është kërkuar informacion Kompanisë Bio Save Tirana, lidhur me problematikën e ngritur nga Fondacioni Doën Syndrome Albania.

Në mungesë të përgjigjes nga ana e Bio Save Tirana, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, me shkresën me nr.1182/3 prot., datë 13.11.2018 Komisioneri ka njoftuar dhe ka ftuar palët në proces për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, të planifikuar me datë 26.11.2018.

Meqenëse u kërkuua shtyrja e seancës nga ana e Fondacionit Doën Syndrome Albania, u vendos që seance dëgjimore të zhvillohej me datë 05.12.2018, ora 11:30, pranë ambjenteve të Zyrës së KMD-së dhe për këtë palët u njoftuan nëpërmjet shkresës me nr.1182/4 prot., datë 27.11.2018

Seanca u zhvillua me praninë e palëve:

- Subjekti ankues i përfaqësuar nga themeluesja e Fondacionit Doën Syndrome Albania (Fondacioni), E. Z. Ishin të pranishëm edhe z.E. G, znj.F. Sh, znj.M. J, znj.E. P, në cilësinë e prindërve që kanë fëmijë me sindromën doën.
- Pala kundër së cilës është paraqitur ankesa, u përfaqësua me autorizim të posaçëm nga D. K.

Gjatë seancës dëgjimore, palët në proces paraqiten edhe një herë pretendimet dhe prapësimet e tyre lidhur me dy momentet me karakter diskriminues, të pretenduara nga subjekti ankues (Fondacioni):

Së pari, pretendimi i Fondacionit lidhur me përmbajtjen e testit të quajtur Harmony Prenatal Test, test i cili bëhet nga gratë shtatzëna për të zbuluar gjendjen e kromozomeve tek fëmija, sa i takon:

- Sloganit të përdorur nga kompania Bio Save Albania: “Të jeni të lumtur!”, e marrë nga kompania origjinale e cila përdor sloganin “Be careless!”, për të cilën shprehen se është e gabuar, paragjykyese dhe diskriminuese, pasi nënkupton që një familje me fëmijë me sindromën doën nuk është një familje e lumtur.

- Informacionit të gabuar rreth sindromës doën, pasi në shpjegimin e kësaj sindrome broshurat citojnë: “...*mangësi të lindura: zemra, fytyra, rritja*”, gjë që sipas tyre jep informacion keqorientues për prindin.

Sa i takon pretendimit të Fondacionit lidhur me përmbajtjen e broshurës/ testit të quajtur Harmony Prenatal Test, Kompania Bio Save Tirana në parantezë sqaroi se cili ishte fokusi dhe qëllimi i veprimtarisë së tyre dhe parashitroi se, misioni i tyre nuk është kurrsesi denigrimi apo keqorientimi i askujt. Përfaqësuesja e Kompanisë u shpreh se ata kanë investuar në edukimin e prindërve të ardhshëm dhe në kuadër të kësaj janë organizatorë të klasave të edukimit perinatal. Këto klasa ofrojnë mësim falas për çdo grua shtatzënë apo çift që shpreh dëshirën për të

marrëpjesë në këtë program. Po ashtu, Kompania ka sponsorizuar dhe mbështetur fondacione të ndryshme, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit ndaj çdo vështirësie apo rreziku që paraqet shtatzania.

Lidhur me broshurën Harmony Prenatal Test, Kompania sqaroi se ky është një material marketingu, me të dhëna zyrtare nga partneri i tyre, Laboratori Gjerman Cenata dhe është i përshtatur në shqip, sipas nevojave të Grupit Bio Save. Slogani “Të jeni të lumtura” në versionin origjinal në gjuhën angleze është “Be care free” dhe ka si qëllim të orientojë ndaj saktësisë së testit. Përfaqësuesja e Kompanisë sqaroi në vijim se: *“Në mjekësi aplikohen mjete të ndryshme diagnostikuese për të identifikuar probabilitetin e anomalive kromozonale, siç janë: bitesti, triplet testi, amniocenteza. Krahas testit Harmony në Shqipëri ofrohen edhe teste të tjera që kategorizohen në të njëjtin grup me testin Harmony, siç është testi “Non Invasive Prenatal Test” ose Teste Prenatale Jo Invazive. Slogani i përdorur nga Kompania targeton sigurinë dhe saktësinë e teknologjisë NIPT në përgjithësi dhe aspak nocionin që një familje e cila ka një fëmijë me sindromën doënështë e pa lumtur. Ne mohojmë kategorikisht pretendimin që Kompania po nxit në ndonjë mënyrë apo po këshillon prindërit e ardhshëm të kryejnë abort/ndërprerje shtatzania për çfarëdo arsyeje. Ne vetëm i mundësojmë atyre informacion rreth çrregullimeve të ndryshme kromozonale. Asnjëherë gjatë punës sonë, në bashkëpunim me mjekët dhe prindërit e ardhshëm nuk ka ndodhur që ne tu kemi rekomanduar atyre ndërprerjen e shtatzanisë”.*

Lidhur me sa më sipër, u ra dakort mes palëve që, nëse Fondacioni ka statistika mbi bazën e të cilave të mund të interpretohej apo provohej impakti që testi Harmony kishte patur në çifte apo që t’i kishte nxitur ata drejt ndërprerjes së shtatzanisë, t’i paraqiste në cilësi prove pranë KMD-së.

Sa i takon pretendimit tjetër të Fondacionit lidhur me informacionin dhe shpjegimet e gabuara që broshura bën lidhur me cilësime të tilla, referuar sindromit doën: *“...mangësi të lindura: zemra, fytyra, rritja”*, përfaqësuesja e Kompanisë sqaroi se: *“të gjitha materialet e përdorura nga Kompania mundësohen nga departamenti i marketingut të Koorporatës Bio Save dhe mbështetur në të dhëna të ofruara ndaj nesh nga Laboratori Cenata, i cili është laborator i specializuar në teknologjinë e NIPT, dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga ajo angleze, por gjithsesi nëse ka patur keqpërshtatje do e rishikojmë këtë çështje dhe në këtë sens jemi të hapur për të bashkëpunuar dhe me Fondacionin”.*

Së dyti, lidhur me pretendimin e Fondacionit për caktimin e dëmshpërblimit nga ana e KMD-së, E. Z është sqaruar nga ana e KMD-së që kjo kërkesë është jashtë juridiksionit të këtij institucioni.

Së treti, lidhur me kërkesën e subjektit ankues sa i takon kërkimin të ndjesës publike nga ana e Kompanisë, D. K e kundërshtoi duke sqaruar se: *“ Broshura nuk i është drejtuar publikut të gjerë dhe është e destinuar vetëm për target grupin e mjekëve. Në asnjë prej rrjeteve sociale që ne si Kompani përdorim, si: facebook apo instagram, nuk është e reklamuar kjo broshurë, gjë që provon deklarin tonë se Kompania këtë broshurë e ka orientuar vetëm ndaj mjekëve dhe jo pacientëve. Për sa kohë nuk i drejtohet një publiku të gjerë dhe kërkesa për ndjesë publike nuk qëndron”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me shërndarjen informacionit të pakuruar përmes testit Harmony, nga ana e Kompanisë Bio Save Tirana.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezultoi se:

Kompania Bio Save Tirana është partner ekskluziv i Bankës Gjermane lider në Europë për ruajtjen e qelizave staminale FamiCord Group dhe Partner Ekskluziv i Laboratorit Gjerman Cenata GmbH për Testin Gjenetik Prenatal Harmony. Kompania Bio Save Tirana është Partner i Testit Harmony për Shqipërinë. Harmony Prenatal Test është një test për zbulimin e hershëm të anomalive kromozomale dhe është një material marketingu, marrë nga Laboratori Gjerman Cenata, i cili është laborator i specializuar në teknologjinë e NIPT, i përkthyer në gjuhën shqipe nga ajo angleze. Ky material është një broshurë me karakter informues dhe që orientohet drejt një target grupi të përcaktuar që janë personel mjekësor. Në përmbajtjen e tij ka këto nën rubrika:

- Përse në botë çdo 2 minuta një grua shtatzënë vendos për testin Harmony?

Këtu evidentohet se Harmony është një test udhëheqës botëror jo-invaziv për zbulimin e hershëm të anomalive në numrin e kromozomeve, dhe daton që nga Marsi i vitit 2012. Të dhënat e përdorura janë marrë nga praktika klinike në trizominë fetale të kromozomeve 21 (2012-2016). Këtu i vihet theksi sigurisë së testit me 99.99% të tij në rastet kur foshnja nuk ka sindromin doën dhe 99.6% në rastet kur foshnja ka sindromin doën.

- Si bëhet testi harmony?

Në këtë rubrikëka informacion lidhur me mënyrën e realizimit të testimit gjenetik.

- Cilat janë anomalitë kromozomale?

Në këtë rubrikë jepet informacion lidhur me anomalitë kromozomale: Trizomin 21/Sindromin Doën, Trizomin 18/Sindromin Edëards, Trizomin 13/Patau, krahasimin e metodave të ekzaminimit mes Harmony Test, Amniocentezës, Double Testit dhe Triple Testit si dhe shkallën e zbulimit dhe rrezikut të testeve të kontrollit për të përcaktuar Sindromin Doën.

Tek përshkrimi që i bëhet në test Trizomit 21/Sindromit Doën citohet:

- Vonesë në zhvillimin mendor e lehtë/e matur.
- Mangësi të lindura: zemra, fytyra, rritja.

- Opsionet e testit harmony.

Në këtë rubrikë jepet informacion lidhur me dy testet Harmony: Classic dhe Expert.

- Rreziku për gratë shtatzëna për sindromin doën (SD).

Në këtë rubrikë jepet informacion lidhur me probabilitetin që mund të ketë një grupmoshë e caktuar grash për të lindur foshnja me SD. Në këtë kontekst, fjala “rreziku” mund të rishikohet dhe një opsion mund të ishte “probabiliteti” pasi testi dhe objektivisht ka të bëjë me mundësinë që gratë e moshës mbi 35 vjeç (referuar statistikave të paraqitura po aty) kanë për të lindur foshnja me SD.

Theksojmë se pranë KMD-së, nga ana e Fondacionit nuk u sollën prova, statistika mbi bazën e të cilave të mund të interpretohej apo provohej impakti që testi Harmony kishte patur në çifte apo që t’i kishte nxitur ata drejt ndërprerjes së shtatzanisë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me të dhënat e broshurës Harmony Prenatal Test i është referuar informacionit të faqes zyrtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH-së)², lidhur me trajtimin dhe studimin e SD edhe PSD.

Komisioneri vlerëson se fjalët e përdorura në test për përshkrimin fizik të personave me sindromin doën (PSD), sa i takon mangësive të lindura: zemër, fytyrë, rritje, janë dhënë pa asnjë referencë shkencore apo shpjegim mjekësor. Dhe pikërisht, dhënia e informacionit në mënyrë të pakuruar mund të krijojë shteg për keqinterpretime, pavarësisht faktit se ky informacion i drejtohet atij grupi personash që janë personel mjekësor dhe që presupozohet se kanë njohuritë e nevojshme mjekësore për të kuptuar informacionin në mënyrën e duhur. Komisioneri, vlerëson se, parë në këtë prizëm, shoqërimi dhe ilustrimi i informacionit me linqe apo tabela ku të mund të gjenden të dhëna statistikore apo mjekësore, orienton në mënyrë më të saktë të gjithë personat që merren dhe punojnë me personat me sindromin doën (PSD), edhe pse ato mund të jenë pjesë e personelit mjekësor (pediatër, gjinekologë etj), pasi ky lloj informacioni është shumë specific, referuar PSD.

Bazuar në sa mësipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i paraqitur në këtë broshurë, në vetvehte është i saktë, mirëpo mos vënia e burimit se ku mund të merret një informacion më i detajuar dhe i bazuar në fakte, statistika dhe studime konkrete, mund të lërë shteg për keqinterpretim (qoftë edhe hipotetikusht) të këtyre termave apo koncepteve.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2³ te ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe

²<https://www.who.int/>

³Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27 (ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Referuar Vendimit nr.429 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Fondacioni Doën Syndrome Albania me datë 09.01.2013 është themeluar si organizatë jofitimprurëse që ka për mision dhe qëllim: *“...Përkushtimin në promovimin dhe përkrahjen e së drejtës legjitime të pranimit, përfshirjes dhe integritetit të personave me sindromën doën në shoqërinë shqiptare, bazuar në KEDNJ dhe KEDPAK, duke informuar dhe ndërgjegjësuar drejt opinionin publik, institucionet vendimmarrëse dhe të palëve të tjera të interesit, si dhe të kontribuojë në zhvillimin e potencialit maksimal tek personat me sindromën doën. ”.*Në fokus të veprimtarisë së Fondacionit, po këtu, citohet të jetë:

- Ofrimi i informacionit për familjarët, kujdestarët, edukatorët, mësimdhënësit dhe profesionistët që punojnë me personat me sindromën doën si dhe për të gjithë palët e interesit.
- Rritja e ndërgjegjësimin të opinionit të gjerëpublik për sindromën doën dhe potencialit të personave me këtë sindromë për të qnë anëtarë të vlefshëm në shoqëri.
- Përfaqësimi i personave me sindromën doën.
- Mbështetja për fëmijët dhe të rriturit me sindromën doën.

Pra, nga sa shihet objekti i veprimtarisë së Fondacionit Doën Syndrome Albania është mbrojtja efektive e të drejtave të personave me sindromën doën, gjë që e legjitimon *“locus standi”* organizatën për të paraqitur ankesë në emër të komunitetit për çdo pretendim për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Termi *“person/fëmijë me aftësi të kufizuara”*, përdoret për të gjithë ata persona/fëmijë, të cilët janë diagnostikuar dhe vlerësuar si të tillë nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Ky është një komision i specializuar mjekësor, i cili vlerëson gjendjen mjekësore të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, Komisioni i caktuar për vlerësimin e personave/fëmijëve me sindromën doën përdorë termin *“person/fëmijë apo person me aftësi të kufizuar”*.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri vlerëson se personat me sindromën doën, të përfaqësuar nga Fondacioni Doën Syndrome Albania, bartin shkakun e aftësisë së kufizuar.

“Aftësia e kufizuar” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje.

A. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ka një sjellje diskriminuese nga ana e Kompanisë Bio Save Tirana, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁴ dhe trajtimit të pa drejtë.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta⁵ si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Qëllimi kryesor sikurse përcakton vetë fjala “test” i Harmony Test është aidiagnostikues për të identifikuar probabilitetin e anomalive kromozonale tek nëna shtatzanë.
- Broshura/testi Harmony është i orientuar për t’i shërbyer një target grupi të caktuar/personelit mjekësor.
- Materiali i broshurës, objekt ankimimi tek KMD-ja, nuk provohet t’i jetë drejtuar apo shpërndarë një publiku të gjerë (as përmes rrjeteve sociale facebook apo instagram).
- Rezulton të jetë përdorur informacion i saktë por i pakuruar mirë, sikurse është trajtuar më sipër në vendim, i cili mund të lerë shteg për keqinformim apo keqinterpretim.
- Rezulton se janë tërhequr nga qendrat shëndetësore ku ishin shpërndarë të gjitha broshurat deri në daljen e broshurave të reja.
- Rezulton i provuar përpara Komisionerit vullneti i mirë i Kompanisë Bio Save Tirana për të korrigjuar dhe bashkëpunuar me subjektin ankues, Fondacionin Doën Syndrome Albania për broshurën e re, duke u dakortësuar për termat dhe terminologjinë e duhur.

Pra, pavarësisht situatës fillestare, faktike/ekzistente në fillim të shqyrtimit të kësaj ankese, gjatë trajtimit të saj dhe përgjatë komunikimit shkresor dhe jo vetëm me KMD-në, Kompania ka shprehur vullnetin e mirë për të tërhequr nga qarkullimi të gjitha broshurat e shpërndara prej tyre (tek personeli mjekësor nëpër qendrat shëndetësore të Tiranës) si dhe ka ftuar për bashkëpunim konkret subjektin ankues, Fondacionin Doën Syndrome Albania për përgatitjen e broshurave të reja. Aktualisht procesi i përgatitjes së tyre është daluar nga ana e Kompanisë, pikërisht për shkak të pritshmërisë së tyre për bashkëpunim me Fondacionin Doën Syndrome Albania.

⁴ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁵Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive*”.

Për sa më sipër rezulton se broshura e Kompanisë Bio Save Tirana nuk cënon dinjitetin e personave dhe nuk krijon një mjedis frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues apo ofendues kundrejt personave me sindromë doën. Ajo ka më shumë karakter informativ dhe nuk synon denigrimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe nuk shpreh negativitet kundrejt këtyre personave.

Në interpretim të informacionit të sipërcituar, Komisioneri gjykon dhe vlerësonse kërkesa e Fondacionit Doën Syndrome Albania, është plotësuar nga ana e Kompanisë Bio Save Tirana, pasi janë marrë masat për rregullimin e situatës, duke hequr nga “qarkullimi” broshurën për të cilën ishte paraqitur ankesa. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana e Fondacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se situata e pretenduar nga subjekti ankues është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Sa i takon pretendimit të Fondacionit për dëmshpërblim, Komisioneri vlerëson se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat e Tij.

Sa i takon pretendimit të Fondacionit për ndjesë publike, Komisioneri vlerëson se përsa kohë që testi nuk i drejtohet një publiku të gjerë, në këto rrethana, nuk vlerëson si të justifikuar kërkesën e subjektit ankues për ndjesë publike nga ana e Kompanisë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma b), si dhe nenin 33, pikat 2, 3, 5, 7, 8 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit në formën e shqetësimit, të Fondacionit Doën Syndrome Albania, nga ana e Kompanisë Bio Save Tirana.
2. T’i rekomandojë Kompanisë Bio Save Tirana, të rikonsiderojë vendosjen e informacionit të kurrar dhe me referenca, të burimit se ku mund të merret informacion më i plotë dhe i detajuar, duke patur në konsideratë dhe bashkëpunimin me Fondacionin Doën Syndrome Albania dhe çdo organizatë tjetër që ka në fokus të veprimtarisë së vet punën me SD dhe PSD.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Aftësia e kufizuar